



Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nën paragrafin 2.6 dhe 2.16, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregulla për vendosjen e çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut (Rregulla për Çmimet të OST/OT);
- Aplikacionin e KOSTT-it të dorëzuar në kuadër të Shqyrtimit të Shtatë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE7) me dokumentacionin relevant sqarues.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, **në seancën e mbajtur më 22 mars 2013 nxori këtë:**

VENDIM

- I. APROVOHEN TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (MAR)** që do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Tregut SHA (KOSTT) përmes tarifave dhe ngarkesave për periudhë rregullative 5 vjeçare duke filluar nga 1 prill 2013 deri më 31 mars 2017.

ARSYETIM

- ✚ Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka pranuar nga KOSTT-i aplikacionin për aprovim të Hyrave të Lejuara Maksimale që duhet mbledhur nga OST/OM përmes tarifave dhe ngarkesave të rregulluara që do të hyjnë në fuqi nga 1 prilli 2013 deri më 31 mars 2017.
- ✚ Në marrjen e vendimit të tij për MAR që do të mbulohet nga OST/OM, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet si në vijim që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen e saj:
 - Vlerësimi fillestar i formularëve të raportimit të KOSTT-it me datën 19 tetor 2012;
 - Vlerësimi i përkohshëm – Raporti i Detajuar mbi Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut të Kosovës (KOSTT sh.a.) i publikuar me datën 8 janar 2013;
 - Vlerësimi përfundimtar, Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut të Kosovës (KOSTT sh.a.) i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
 - Vlerësimi përfundimtar- Pasqyrë i publikuar me datën 22 shkurt 2013.

- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale** që do të mbulohen nga OST/OM për periudhë rregullative 5 vjeçare duke filluar nga 1 prilli 2013 deri më 31 mars 2017 janë paraqitura në tabelën në vijim.

Vlerësimi i përfundimtarë i MAR për bizneset e licencuara të KOSTT-it	2013	2014	2015	2016	2017	Total
	€ m	€ m	€ m	€ m	€ m	€ m
Gjithsej	17.5	18.2	19.2	20.3	21.5	96.7



- III. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për OST/OM të paraqitura në tabelë do t'i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta vjetore dhe zbatimit të Faktorit Profilizues, sipas Rregullës për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të transmisionit dhe tregut.
- IV. Të Licencuarit për OST/OM duhet t'i përgatisin dhe dorëzojnë për aprovim ZRRE-së ngarkesat për shfrytëzim të sistemit të transmisionit (TUOS) të përcaktuar me këtë Vendim brenda një afati sa më të shkurt.
- V. Ngarkesat e propozuara nga OST/OT duhet të jenë në përputhje me Parimet e Përcaktimit të ngarkesave në transmision të lëshuara nga ZRRE.
- VI. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të përkthimeve, do të mbisundojë versioni i gjuhës shqipe.
- VII. Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

Bordi i ZRRE

Enver Halimi, Kryesues

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar

Merita Kostari, Anëtar

Krenar Bujupi, Anëtar